

SQ

# 7003 METAL BRO



<b>PËRSHKRIM</b>	Detergjent dhe deoksidues për sipërfaqe të forta prej metali dhe lidhje metalike të lehta.
<b>KARAKTERISTIKAT</b>	Eliminon në mënyrë efikase papastërtitë dhe oksidet pa gërvishje dhe pa lënë vazhda. I rikthen sipërfaqeve të trajtuara shkëlqimin e tyre origjinal, duke garantuar një rezultat afatgjatë.
<b>PËRDORIMI DHE KOMPATIBILITETI</b>	Çelik, inox, bakër, tunxh, bronz dhe alumin. Mos të përdoret mbi dru dhe materiale të ndjeshme ndaj acideve. Largoni menjëherë cirkat e solucionit nga sipërfaqet e ndjeshme ndaj acideve dhe i shpëlani me ujë të bollshëm.
<b>MËNYRA E PËRDORIMIT DHE DOZIMI</b>	Gati për përdorim. Aplikojeni produktin mbi sipërfaqen që dëshironi të pastroni duke përdorur një penel, një bidon me grykë spërkatëse ose një sfungjer jo gërryes. Fërkojeni sipërfaqen që dëshironi të pastroni në drejtim të akrepave të orës si dhe në drejtim të kundërt. Shpëlajeni sipërfaqen me një leckë të njomur me ujë ose me një hidropastruese.
<b>SPECIFIKIMET</b>	Paraqitja: lëng transparent pa ngjyrë pH: 1,0 +/- 0,5 Pesha specifike [g/ml]: 1,045 +/- 0,020
<b>MASAT PARAPRAKE PËR PËRDORIM DHE RUAJTJE</b>	Të ruhet në enët origjinale. Të shmangen temperaturat ekstreme. Për më tepër informacione mbi përdorimin dhe flakjen, shihni fletën e të dhënave për sigurinë.
<b>PËRBËRJE KIMIKE</b>	Për më tepër informacione mbi përbërësit e produktit, shihni fletën e të dhënave për sigurinë.
<b>PARALAJMËRIME</b>	<b>PRODUKTI ËSHTË I PËRSHTATSHËM VETËM PËR PËRDORIM PROFESIONAL.</b> Informacionet e përfshira në këtë Fletë të të Dhënave Teknike, rekomandimet për përdorim dhe aplikimet e produktit bazohen në njohuritë tona dhe në testet e kryera mbi produktin deri në datën e përpilimit të këtij dokumenti. Produkti mund të ketë aplikime të ndryshme dhe kushtet e funksionimit mund të ndryshojnë sipas materialeve dhe kushteve mjedisore për të cilat ne nuk jemi në dijeni. Për këtë arsye, Italtchimica nuk mund të jetë përgjegjëse për përshtatshmërinë e produktit dhe rezultatet për proceset tuaja duke mos njohur detajet e kushteve tuaja të përdorimit. Për të konfirmuar përshtatshmërinë rekomandojmë të kryeni prova në një pjesë të vogël të sipërfaqeve. Firma nuk mban asnjë përgjegjësi në rast se produktet e saj përdoren në mënyrë të gabuar. Shërbimi ynë teknik është i disponueshëm për të gjetur kushtet optimale për të përdorur produktet.

**PROFESSIONAL  
ACADEMY**

 Get more information  
on your smartphone.


PALLETIZATION	<b>CODE</b>	7003	<b>EAN</b>	8050999570413		
	<b>Pcs x Box</b>	2	<b>Volume L</b>	5	<b>Fl. Oz.</b>	169,07
	<b>Box x Layer</b>	18	<b>Peso Kg</b>	5,5	<b>Oz.</b>	194,01
	<b>Box x Pit</b>	72				

**WWW.SANITECITALIA.COM**

LAST UPDATE: 13/12/2021

REV. 00/2021